



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INFRASTRUKTURËS PUBLIKE
SEKTORI I PROJEKTEVE PUBLIKE



RELACION TEKNIK

OBJEKTI: “NDËRTIM TERRENI SPORTIV NË SHËNVLASH”

ADRESA: SHËNVLASH, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL

BASHKIA Durrës

Përmbajtja:

- 1.1. PËRSHKRIM I GJËNDJES EKZISTUESE**
- 1.2 QËLLIMI I RELACIONIT**
- 1.3 FOTOGRAFI TË GJËNDJES EKZISTUESE**
- 1.4 PROBLEMATIKAT E EVIDENTUARA**
- 1.5. PËRSHKRIMI I NDËRHYRJES**
- 2. DETAJE TË PROJEKTIMIT**
- 3. PROPOZIMI I PROJEKT IDESË**

- 1.1. PËRSHKRIM I GJËNDJES EKZISTUESE**



Figura 1. Pozicionimi ne lidhje me Gjeoportalin Asig

1.2 QËLLIMI I RELACIONIT

Ky relacion hartohet me synimin për rikualifikimin e kësaj hapësire publike dhe transformimin e saj në një zonë rekreative dhe argëtuese në shërbim të komunitetit. Projekti parashikon rehabilitimin e hapësirave ekzistuese sportive, të cilat aktualisht janë të amortizuara dhe nuk përmbushin standardet e nevojshme për aktivitete sportive, si edhe ndërtimin e një sheshi të ri multifunksional që do të jetë në dispozicion të të gjithë qytetarëve për aktivitete sociale, rekreative dhe kulturore.

Ky investim pritet të përmirësojë në mënyrë cilësore hapësirat e kësaj zone, të ofrojë kushte dhe mundësi më të mira rekreative për banorët dhe të nxisë zhvillimin e aktiviteteve sportive.

1.3 FOTOGRAFI TË GJENDJES EKZISTUESE







Figura 2, 3, 4, 5 Gjendja ekzistuese e fushës

1.4 PROBLEMATIKAT E EVIDENTUARA

- Fusha e sportit e amortizuar dhe jashtë standarteve
- Mungesa e rrethimit, shtrimit me tapet, ndricimit, podiumit per spektatorët, etj.
- Mungesa e ambjenteve rekreative per komunitetin. Nevoja per hapësira per femijet dhe per te moshuarit.

1.5 PËRSHKRIMI I NDËRHYRJES

Nëpërmjet këtij projekti synohet rehabilitimi dhe zhvillimi i fushës. Projekti parashikon krijimin e një fushe futbolli multimodale si dhe rrethimit të fushës për sigurinë dhe mirë administrimin e sajë. Gjithashtu krijimin e ambienteve të tjera rekreative, për fëmijet dhe për të moshuarit.

Objektivi i këtij projekti është rikonceptimi i hapësirës publike të fushës, duke synuar rigjenerimin e ambjenteve të jashtme që do të promovojnë jetën në komunitet dhe hapësira të dedikuara për aktivitetet sportive në zonë.


Thelbësore në këtë ndërhyrje është dhe sistemimi i rrjetit të kullimit të fushës dhe shtrimi i sajë me material të përshtatshëm sipas standarteve të sipërcituara.

Në përfundim të investimit, banorët e zonës do të kenë mundësi të aksesojnë një hapësirë publike të rikualifikuar e cila përmbush nevojat për zhvillimin e një jete më cilësore.

Rrethimi i fushës

Rrethimi i fushave sportive do të jetë konstruksion metalik me një lartësi prej 5m, ku 50 cm do te jete inkastrimi I shufrave ne themel deri në lartësinë 2m do te jetë rrjetë metalike dhe 2.5m e tjerë rrjetë plastike. Parashikohet lyerja e rrethimit me bojë. Konstruksioni i rrethimit do të mbahet nga themele monolit b/a C-16/20. Aksesit për në këto fusha do të bëhet nga portat e reja të këtij rrethimi.


PAMJE RRETHIMI 3 SH 1:100



Punime shtresash

Fusha multimodale:

Fusha sportive e futbollit do te kete siperfaqe prej 2186 m2 dhe propozohet të ketë këto shtresa: 20 cm shtresë cakelli të përhapur dhe ngjeshur me makineri, 10cm shtrese stabilizanti,shtrese rere silici,shtrese plastike kokrrizore dhe tapet sintetik.



Shtimi i sistemit të drenazhimit

Parashikohet pajisja e te gjithë hapësirës me kuneta betoni dhe puseta b/a shiu me kapak zgare hekuri. Sistemi i drenazhimit do të bëhet ne perimetrin total të fushës dhe do te lidhet me rrjetin ekzistues urban.

Sistemime pas ndërhyrjeve

Projekti parashikon dhe sistemime të nevojshme pas procesit të ndërhyrjes si mbushje me dhe dhe vegjeta për lulishte dhe mbjellje bar dhe sistemim i sheshit përreth fushave ne menyre qe zona te kryej dhe nje funksion gjithperfshires ne lidhje me komunitetin duke u transformuar ne nje zone polifunksionale me shehshe qendrimi dhe lojra te tjera individuale.

Figura 6– Planimteria e fushës së sportit, Katund i Ri

2. DETAJE TE PROJEKTIMIT

1. Detajimi i mëtejshem i projektit konceptual dhe përgatitja e projektit të zbatimit. Zbatimi i projektit pritet të përmirësojë në mënyrë cilësore hapësirat e kësaj zone.
 - Rehabilitimin dhe zhvillimin e fushës multimodale;
 - Të ofrojë kushte dhe mundësi më të mira rekreative për banorët;
 - Të nxisë zhvillimin e aktiviteteve sportive në zonë;
 - Të rrisi frekuentimin e zonës ;
 - Të unifikojë vizualisht e funksionalisht zonën.

3. PROPOZIMI I PROJEKT IDESË

Projekti propozon nderhyrjen ne kete zone me keto tregues zhvillimi, sipas planvendosjes se meposhtme.

PLANI I VENDOSJES SË OBJEKTIT PËR LEJE NDËRTIMI: "NDËRTIM TERRENI SPORTIV NË SHËNVLASH",
NË PASURINË NR. 133, ZONA KADASTRALE 3339,
ME VENDNDODHJE RRUGA "VRINI", NËSIA STRUKTURORE DR_UB_AR1_471/26 ,
NË PRONË TË "BASHKISË DËRRËS" DHE ZHVILLUES "BASHKIA DËRRËS"

SIPËRFAQJA E TRUALLIT 4950 M²


SH 1:1000



SKEMA E VENDOSJES SË ZONËS SË ZHVILLIMIT
SHKALLA 1:3000



POZICIONI KADASTRAL
ZONA KADASTRALE 3339 Nr.pas. 133; SHKALLA 1:3000



MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISË DËRRËS

EMIRIANA SAKO

TREGUESIT E ZHVILLIMIT

PASURIA ME NUMER 133, ZONA KADASTRALE 3339	
SIPËRFAQJA E TRUALLIT QË ZHVILLOHET	4950 M ²
SIPËRFAQJA E TRUALLIT E ZËNË NGA STRUKTURA	0 M ²
SIPËRFAQE PER FUSHEN MULTIMODALE	1130 M ²
SIPËRFAQE PER PARKIM	245 M ²
SIPËRFAQE PER HAPESIRE REKREATIVE	784 M ²
SIPËRFAQE E GJELBERUAR	440 M ²
SIPËRFAQE RRUGE PER BIKIKLETA	174 M ²
SIPËRFAQE E SISTEMUAR PER TROTUAR	600 M ²

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DËRRËS PLANI I VENDOSJES SË OBJEKTIT PËR LEJE NDËRTIMI: "NDËRTIM TERRENI SPORTIV NË SHËNVLASH", NË PASURINË NR. 133, ZONA KADASTRALE 3339, ME VENDNDODHJE RRUGA "VRINI", NËSIA STRUKTURORE DR_UB_AR1_471/26 , NË PRONË TË "BASHKISË DËRRËS" DHE ZHVILLUES "BASHKIA DËRRËS"		
DREJTOR:	ANA HOXHA	
SPECIALIST:	EMËR MBIEVËR	
PROJEKTUES:	ARK. _____ LIC. A. _____	FIRMA

TREGUESIT E ZHVILLIMIT

PASURIA ME NUMER 133, ZONA KADASTRALE 3339

SIPËRFAQJA E TRUALLIT QË ZHVILLOHET 4950 M²

SIPËRFAQJA E TRUALLIT E ZËNË NGA STRUKTURA 0 M²

SIPËRFAQE PER FUSHEN MULTIMODALE 1130 M²

SIPËRFAQE PER PARKIM 245 M²

SIPËRFAQE PER HAPESIRE REKREATIVE 784 M²

SIPËRFAQE E GJELBERUAR 440 M²

SIPËRFAQE RRUGE PER BIKIKLETA 174 M²

SIPËRFAQE E SISTEMUAR PER TROTUAR 600 M²

Figura 8– Planimetria e kullimit të fushës së sportit



Figura 9 – 3 dimensional projekt ideja e fushës.

Punoi:

Ark. Bianka Madhi

Ing. Ilva Hasanaj

Ark. Nevian Mance